



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-15065/23 datë:19.06.2023



Npi – 01/249 datë: 27.06.2023

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d), nenin 17 shkronja (k), si dhe nenin 24, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i propozon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të merr vendim për plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi – 01/32 datë: 27.01.2023, për ndarjen nga 100€ të specifikuara për destinimin e veçantë për Nënata-Lehona. Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi analizoi propozimin e Drejtorisë, dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT Npi – 01/32 datë: 27.01.2023 PËR
NDARJEN NGA 100 € PËR NËNAT LEHONA**

I

Kuvendi Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VI- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më 27.06.2023, unanimisht miratoi Vendimin për plotësimin e vendimit të Kuvendit Npi – 01/32 të datës 27.01.2023, për ndarjen nga 100€ (njëqind euro) për secilën Nënë-Lehonë, për ç'do fëmijë të lindur në vitin 2023.

Në dispozitiv të vendimit Npi – 01/32 shtohen edhe fjalët:

1. ("Të drejtën mbi bazën e vendimit Npi-01/32 për përfitimin e 100€ për çdo fëmijë të lindur e gëzojnë edhe të gjitha Nënata lehona që nuk e posedojnë shtetësinë e Kosovës por që janë të martuara me burrat që kanë shtetësinë e Kosovës").
2. Të drejtën mbi bazën e vendimit Npi-01/32 për përfitimin e 100€ e gëzojnë edhe të gjitha Nënata lehona që kanë lindur fëmijën pa shenja jete ose që pas lindjes ka ndërruar jetë.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës Komunale për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi